

# Përmbajtja

Parathënie .....	9
Hyrje .....	13
Pjesa I-GJUHA .....	15
1 Lindja e gjuhëve letrare ballkanike moderne – studim krahasues.....	17
2 Studimet mbi gjuhët sllave të Ballkanit, mbi letërsinë dhe historinë në Bashkimin Sovjetik gjatë dhjetëvjeçarit të fundit.....	36
3 Gjuha si faktor i identitetit kombëtar në Ballkanin e shekullit XIX.....	47
4 Gjuha dhe politika në Ballkanin e kohës sonë: Shqipëria, Jugosllavia dhe Greqia.....	53
Pjesa II- FOLKLORI.....	73

5	Dhjetërokëshi i sllavëve të jugut në poezinë gojore epike shqiptare.....	75
6	Modelet kulturore në ciklin e Mujit e Halilit.....	89
7	Razgovor i Kaçiqit dhe Lahuta e Malcis e Fishtës.....	119
8	Këngët e kleftëve dhe të hajdukëve: histori apo letërsi gojore? .....	138
9	Këngët heroike serbokroate dhe mjedisi i tyre përkatës.....	148
	Pjesa III- HISTORI .....	169
10	Feja në Shqipëri gjatë sundimit osman.....	171
11	Mjedisi kompleks i veprimtarisë së Skënderbeut .....	188
12	Sistemi i milletit dhe roli i tij në zbehjen e identitetit kombëtar ortodoks në Shqipëri .....	209
13	Skënderbeu dhe vetëdija kombëtare shqiptare.....	227

14	Historia e alfabetit shqip: Një rast i një zhvillimi kompleks kulturor dhe politik ..	233
15	Kripto-kristianizmi në zonën e Ballkanit nën sundimin osman.....	252
	Pjesa IV - DY ALBANOLOGË TË SHQUAR DHE VEPRA E TYRE .....	279
16	Alois Schmaus, 1901-1970 .....	281
17	Mosely mbi Zadrugën .....	283
	Bibliografi e përzgjedhur.....	288

## **TITULLI: STUDIME KULTURORE BALLKANIKE**

**AUTORI: STAVRO SKENDI**

Ngjarjet që çuan në Luftë e Parë Botërore i nxorën popujt e Ballkanit në radhën e parë të ndërgjegjes politike perëndimore, por do të duhej edhe një gjysmë shekulli tjetër përpara se studimet amerikane t'i kushtonin këtij rajoni vëmendjen që meritonte. Burrat e shtetit dhe studiuesit amerikanë kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetje të vetëvendosjes kombëtare për popujt e këtij rajoni gjatë punës për marrëveshjet e paqes të vitit 1919 dhe 1920, por ky angazhim i fortë ideologjik nuk u shoqërua edhe me një kuptim të njëjtë të ndërlidhjeve të tij etnike, politike dhe ekonomike.

Kjo nuk na befason, sepse realitetet e Europës Juglindore janë sa të thjeshta aq edhe komplekse. Janë të thjeshta në kuptimin se, të paktën deri para 1945, vendet e këtij rajoni kishin të përbashkët nivelin e ulët të kushteve materiale, sipas standardeve europiane. Ato ishin kryesisht vende bujqësore, dhe me një bujqësi në përgjithësi të prapambetur, pa patur ndonjë rol të rëndësishëm në ekonominë europiane as si furnizues dhe as si treg shitjeje. I përbashkët ishte po ashtu besimi se përmirësimi i dëshirueshëm prej aq shumë kohësh i standardit të jetesës do të mund të arrihej vetëm nëpërmjet krijimit të shteteve të pavarura. Qe pikërisht ky besim në vetëvendosjen kombëtare që bëri për vete imagjinatën amerikane në kohën e Luftës së Parë Botërore, dhe përforcoi bindjen uillsoniane se sapo këto vende do të bëheshin të pavarura, ato do të futeshin menjëherë në rrugën e demokracisë dhe të begatisë.

Kompleksiteti i këtij rajoni nuk ishte dhe aq i qartë për studiuesit amerikanë të kohës së Uillsonit, ndonëse me kalimin e kohës ato filluan të bëhen realitete më të kuptueshme. Rivalitetet e shkaktuara nga lufta për çlirim kombëtar vazhduan edhe për shumë kohë pasi ishte arritur pavarësia. Çdo vend në rajon kishte mosmarrëveshje kufijsh me secilin prej fqinjëve dhe besimi te forca vazhdoi të jetë mjete i vetëm i zgjidhjes së këtyre mosmarrëveshjeve. Ndikimi i fuqive të mëdha te këto vende nuk u bë më pak i dukshëm pas arritjes së pavarësisë, dhe vendet e këtij rajoni u përfshinë në ngjarjet që çuan në Luftën e Dytë Botërore po në atë masë sa edhe në Luftën e Parë. Në themel të këtyre zhvillimeve qëndronin diversiteti i gjuhëve, i feve dhe identiteteve kombëtare dhe ideologjike, të cilat përfaqësonin një pengesë të madhe për unitetin brenda kombeve të e reja si dhe për bashkëpunimin mes tyre.

Stavro Skendi është i paarrtshëm në të kuptuarit dhe në të shpjeguarit të kompleksitetit që karakterizon vendet ballkanike. Sensi i lindur për të kuptuar këtë zonë si një shqiptar me prindër ortodoksë u përforcua edhe më nga arsimimi kozmopolit që ai mori në Robert College në Stamboll, të cilin e mbaroi më 1928, dhe studimet që kreu në Shkollën e Gjenevës të Studimeve Ndërkombëtare, ndërsa kualifikimin për doktor shkencash e mbrojti më 1951 në Universitetin e Kolumbias. Gjatë kësaj kohe, ai mori njohuri për turqishten dhe

mësoi greqishten dhe gjuhët sllave, pa përmendur këtu anglishten, frëngjishten, gjermanishten dhe italishten, çka u dha studimeve të tij aftësinë e rallë për t'i parë problemet e rajonit nga shumë pikëvështrime.

Megjithëse Stavro Skendi i kushton Shqipërisë vëmendjen kryesore, ajo nuk është një temë e kufizuar, sepse brenda kufijve të saj malorë përfshihen edhe problemet karakteristike ballkanike – dhe madje në një formë të skajshme. Ndër gjithë vendet e rajonit gjatë periudhës midis dy luftërave, Shqipëria kishte përqindjen më të lartë të fuqisë së saj punëtore në bujqësi dhe prodhimin më të ulët bujqësor për frymë dhe për hektar. Pengesat politike dhe sociale ndaj çlirimit kombëtar po ashtu ishin më të mëdha në Shqipëri sesa në vendet fqinje, dhe kjo jo vetëm për shkak të ndarjes midis myslimanëve dhe të krishterëve, por edhe si pasojë e politikës osmane që e mbajti shoqërinë fisnore dhe patriarkale të ndarë në mënyrë që ta kishte më të lehtë ta mbante nën kontroll.

Karakteri i veçantë i trashëgimisë shqiptare e ka bërë Stavro Skendin shumë të ndjeshëm ndaj aspekteve kulturore të ndërjegjes kombëtare. Në vëmendje të tij janë përfshirë jo vetëm njohuritë moderne të përcjella nga arsimi dhe botimet, që kanë qenë një element kaq i rëndësishëm për lëvizjet kombëtare, por edhe kultura popullore e shprehur nëpërmjet folklorit dhe gjuhës, që ndërveprojnë me kulturën më të lartë në zhvillim e sipër.

Në fakt, kemi dy Stavro Skendi: një që shkroi disertacionin *Albanian and South Slavic Oral Epic Poetry\**, botuar më 1954, një subjekt që është afër me tematikën e këtij vëllimi; dhe një tjetër që shkroi *The Albanian National Awakening, 1878-1912* (1967), që mbetet vepra më e shquar për historinë politike shqiptare. Në shumë drejtime këto dy tema të gjera u përkasin disiplinave të ndryshme dhe paraqesin interes për grupe të ndryshme studiuesish. Megjithatë, ato formojnë një unitet të natyrshëm jo vetëm se janë vepra të të njëjtit studiues, por edhe se trashëgimia kulturore e shoqërisë vazhdon të luajë një rol qendror në idetë dhe institucionet moderne edhe pasi shprehja e këtyre vlerave ka ndryshuar nga forma gojore në atë të shkruar. Janë të rrallë ata studiues që mund ta thurin një tematikë të tillë kaq të larmishme në një ind të vetëm.

Prill, 1980

Cyril E. Black

Drejtor i Qendrës së Studimeve Ndërkombëtare  
Universiteti i Princeton-it, Princeton, N.J